

# UDHËZUES MBI PUNËN NË LARTËSI

---

Ky Udhëzues i dedikohet punëdhënësve, menaxherëve dhe personave të tjerë brenda vendit të punës që kanë një përgjegjësi për shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.

Ky Udhëzues duhet të përdoret si një mjet ndihme për zhvillimin e sistemeve të sigurta të punës, kurdo që kryhen punë në lartësi.



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo*

*Finansija, Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Inspektorati i Punës/ Inspektorata Rada/ Labour Inspectorate



# PËRMBAJTJA

HYRJE.....	3
PUNA NË LARTËSI – HIERARKIA E KONTROLLIT .....	4
KËRKESAT E PËRGJITHSHME TË PUNËDHËNËSVE.....	6
PLANIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RISKUT TË PUNËS NË LARTËSI .....	7
TRAJNIMI DHE NDËRGJEGJËSIMI.....	9
LEJA PËR TË PUNUAR NË LARTËSI.....	10
PLANI I EMERGJENCËS .....	11
PLATFORMA DHE PAJISJET PËR QASJE .....	12
AUDITIMET .....	16
VËREJTJET PËRFUNDIMTARE.....	16
SHTOJCA .....	17

# HYRJE

Duke qenë në cilësinë e një punëdhënësi dhe pjesë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë brenda biznesit tuaj, ju keni një përgjegjësi për të siguruar që personat që punojnë në lartësi të kenë një sistem të përshtatshëm dhe mjaftueshëm të sigurt të punës. Në përgjithësi, puna në lartësi nënkupton çdo vend, pavarësisht nga lartësia specifike, nga ku punëtorët mund të bien dhe të lëndohen. Kjo përfshin mundësinë për të rënë mbi tokë dhe nën tokë. Kërkesat ligjore përcaktohen në mënyrë të përgjithshme në **LIGJIN NR. 04/L-161 PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË**, dhe më konkretisht brenda Rregullores së MPMS-së Nr. 06/2017 për Kriteret Minimale të Sigurisë dhe Shëndetit në Vendetndërtimet e Përkohshme apo Mobile , respektivisht nenet 9, 11, si dhe Shtojcave 4 dhe 5 të Rregullores së lartpërmendur.

## Çfarë është puna në lartësi?

Puna në lartësi është puna e kryer në çdo vend, duke përfshirë edhe vendet mbi ose nën nivelin e tokës, ku një person mund të lëndohet nëse bie nga ai vend. Hyrja dhe dalja në vendin e punës mund të konsiderohet gjithashtu si punë në lartësi.

Shembuj të aktiviteteve të punës që klasifikohen si punë në lartësi:

- Puna në sipërfaqe të ndjeshme me mundësi të rënies
- Puna në skele
- Puna në kulm të rrafshët
- Montimi kallëpeve
- Puna në shkallë
- Puna në nivelin e tokës ngjitur me një gërmim
- Montimi i kallëpeve brenda gërmimit
- Puna pranë ose ngjitur me materiale të ndjeshme



## Mjedisi dhe kushtet e punës kur punohet në lartësi

Puna në lartësi mund të jetë më e rrezikshme kur mjedisi dhe kushtet janë të pafavorshme, për shembull:

- Sipërfaqe të rrëshqitshme të punës (të lagura, me vaj, me pluhur ose të lëmuara)
- Sipërfaqe jo të rrafshëta të punës (tokë e thyer apo kulme me profile)
- Sipërfaqe të ngushta
- Sipërfaqe të punës ku janë grumbulluar mjete, materiale pune dhe mbeturina
- Punëtorët që punojnë në kushte të pafavorshme të motit (shi, erë, nxehtësi ekstreme ose kushte shumë të ftohta)
- Materiale ndërtimi, mjete të mëdha ose pajisje që duhet të barten manualisht
- Mbingarkesa të platformës së punës, të cilat mund të bien për shkak të ngarkesës.

# PUNA NË LARTËSI – HIERARKIA E KONTROLLIT

Kur ekziston rreziku i rënies nga lartësia në vendin e punës, punëdhënësi duhet të marrë në konsideratë, për aq sa është praktike, masat që duhet të vendosen për të kontrolluar ato rreziqe. Masat e duhura të kontrollit dhe metodat e punës të zgjedhura për të zvogëluar ose ruajtur rrezikun e rënies nga lartësitë duhet të vlerësohen dhe zbatohen me kujdes për të siguruar efektivitetin e tyre.

Kur zhvillohen masat e kontrollit për punën në lartësi, duhet të konsiderohet fillimisht hierarkia e kontrollit të punës në lartësi si pjesë e planifikimit për punën në lartësi. Figura 1 më poshtë përcakton një hierarki të tillë.


Hierarkia e kontrollit të punës në lartësi përdor një qasje tre nivelëshe:

1. **SHMANGNI** punën në lartësi.
2. **PARANDALONI** rëniet duke përdorur pajisje pune.
3. **MINIMIZONI** distancën dhe pasojat e rënies.

Hierarkia sugjeron gjithashtu, kur është e mundur, që ju të përdorni vendet ekzistuese të sigurta të punës. Kjo mund të përfshijë strukturat ekzistuese, barrierat dhe shkallët.

Hierarkia më tej sugjeron trajnim dhe udhëzim - skenari i mundshëm do të ishte një përzjerje e të gjitha niveleve për të krijuar një sistem të sigurt të punës.

Figura 1 – Hierarkia e punës në lartësi



## Niveli 1 - Shmangni punën në lartësi

Kjo mund të bëhet duke lokalizuar vend punimin dhe vendosjen e pajisjeve në nivelin e tokës e jo një kulm ose duke ndryshuar praktikën e punës të tilla si përdorimi i një sistemi të largës me zgjatje për pastrimin e dritareve në vend të përdorimit të shkallëve për kryerjen e një pune të tillë.



## **Niveli 2 - PARANDALONI - kur puna në lartësi nuk mund të shmanget përdorni një vend të sigurt ekzistues për të kryer punën.**

Një gjë e tillë vlen për rastet kur nuk nevojiten pajisje mbrojtëse shtesë dhe nuk ka rrezik të rënies sepse masat parandaluese janë tashmë të vendosura, të tilla si një ballkon ose mur i ulët.

Parandaloni rëniet duke përdorur pajisje kolektive të tilla si platforma të mbrojtura ose mbrojtje me rrethojë. Parandaloni rëniet duke përdorur Pajisjet Mbrojtëse Personale (PMP) siç është sistemi i parandalimit të rënies.

Ky sistem zakonisht përfshin një pikë ankorimi dhe litar të rregulluar ose të vendosur në një gjatësi të caktuar për të parandaluar përdoruesin nga rreziku që mund t'i kanoset.



## **Niveli 3 - MINIMIZO - distancat e rënies duke përdorur pajisje kolektive. Nëse një rënie nuk mund të shmanget, atëherë pasojat e rënies duhet të zvogëlohen**

Pajisjet kolektive të tilla si jastëkat e ajrit të vendosura nën zonën e punës zvogëlojnë distancën që punëtori mund të bjerë. Minimizoni pasojat duke përdorur pajisje kolektive të tilla si rrjeta, të cilat mund të përdoren për të zbutur ndikimin që një rënie mund shkaktojë si dhe për të zvogëluar distancën.

Pajisjet mbrojtëse personale mund të përdoren gjithashtu për të minimizuar distancat e rënies. Pajisjet e tilla si sistemi i ndalimit të rënies duhet të përdoren vetëm si një mundësi e fundit dhe nga ata që tanimë janë të trajnuar t'i përdorin ato.



Sistemet zakonisht përbëhen nga një pikë ankorimi, lidhëse, siç mund të jetë një litar i lidhur, dhe një mbrojtëse e tërë trupit (jo rrip beli ose gjoksi). Nëse përdoruesi bie, sistemi e ndalon forcën dhe ngadalëson rënien në një distancë më të shkurtër.

Së fundmi, ne mund të minimizojmë pasojat e mundshme përmes trajnimit dhe udhëzimit. Kushdo që punon në lartësi duhet të ketë trajnim dhe udhëzim të mjaftueshëm në mënyrë që të kryejë detyrën me kompetencë. Trajnimi duhet të përfshijë praktika të sigurta pune dhe përdorim të duhur të pajisjeve në përputhje me rekomandimet e prodhuesit.

# KËRKESAT E PËRGJITHSHME TË PUNËDHËNËSVE

Është e rëndësishme që punëdhënësit të respektojnë parimet e përgjithshme të hierarkisë së kontrolleve për punën në lartësi, të përcaktuara në figurën 1, duke siguruar që parandalimi i tyre në menaxhimin e rreziqeve nga puna në lartësi, do të marrë në konsideratë tre parime kryesore: shmangien, parandalimin ose minimizimin e rreziqeve.

Punëdhënësi duhet të kryejë vlerësime të rrezikut të aktiviteteve të punës në lartësi, duke u siguruar që e gjithë puna është planifikuar, organizuar dhe kryer nga ana e njerëzve kompetentë.

Punëdhënësit duhet gjithashtu të zgjedhin pajisjet e duhura të punës dhe të zgjedhin masat kolektive për të parandaluar rëniet (të tilla si parrakët e mbrojtjes dhe platformat e punës) para se të ndërmerren masat e tjera që mund të zvogëlojnë vetëm distancën dhe pasojat e një rënieje (të tilla si rrjetat ose jastëku i ajrit) ose mund të sigurojnë vetëm ndalim të rënies përmes pajisjeve të mbrojtjes personale.



Vlerësimi i riskut duhet të përfshijë një ekzaminim të kujdesshëm të asaj se çfarë dëmi mund të shkaktohet nga puna në lartësi me qëllim që të ndërmerren hapa efektiv për zvogëlimin e gjasave të shkaktimit të dëmit. Ose përmes aktivitetit të shmangies, ose, kur kjo nuk është mjaft praktike atëherë puna e cila duhet të kryhet në lartësi duhet të bëhet duke përdorur pajisje pune që janë të përshtatshme për detyrën dhe nivelin e rrezikut me qëllim që të jetë e sigurt.

## **Punëdhënësi duhet të sigurojë që:**

- Është planifikuar dhe organizuar plotësisht e tërë puna në lartësi.
- Është bërë vlerësimi i riskut për gjithë punën që kryhet në lartësi.
- Zgjidhen dhe përdoren pajisjet e duhura të punës.
- Personat, të cilët punojnë në lartësi, janë kompetentë.
- Pajisjet e përdorura për punë në lartësi inspektohen dhe mirëmbahen rregullisht.
- Rreziqet nga sipërfaqet e ndjeshme kontrollohen siç duhet.
- Vendpunimet në lartësi janë të ndriçuara dhe me dukshmëri të mirë.

# PLANIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RISKUT TË PUNËS NË LARTËSI

Planifikimi dhe vlerësimi i riskut të punës në lartësi është kusht kryesor për të gjithë punëdhënësit. Kombinimi i një plani parandalimi nga rënia dhe vlerësimi i riskut siguron një pikë të mirë fillestare në garantimin e sigurisë së punëtorëve kurdo që puna në lartësi është pjesë e aktiviteteve të punës.

**Kur planifikoni, duhet të merrni parasysh kushtet në vijim (kjo listë nuk është shteruese):**

1. Kushtet e motit që mund të rrezikojnë sigurinë e punëtorëve
2. Të kontrolloni që vendi (p.sh. kulmi) ku do të kryhet puna në lartësi është e sigurt. Çdo vend në lartësi, ku njerëzit do të punojnë, duhet të kontrollohet, para përdorimit çdo herë.
3. Të ndaloni rënien e materialeve ose gjësendeve, ose, nëse një gjë e tillë nuk është mjaft praktike, duhet të merrni masa të përshtatshme dhe të mjaftueshme për t'u siguruar që askush nuk do të lëndohet, p.sh. përdorni zona të përjashtimit për të mbajtur njerëzit larg ose rrjetë në skele për të ndaluar rënien e materialeve të tilla si tullat
4. Të ruani materialet dhe objektet në mënyrë të sigurt ashtu që të mos shkaktojnë lëndime nëse lëvizen ose shemben.
5. Të planifikoni për emergjencat dhe shpëtimin, p.sh. caktoni një procedurë për evakuim. Mendoni për situata të parashikueshme dhe sigurohuni që punëtorët të jenë të informuar rreth procedurave të rasteve emergjente. Mos u mbështetni thjesht në planin tuaj për shpëtim në raste të emergjencës për shpëtim.
6. Të përfshini punëtorët në procesin e vlerësimit të rrezikut.

**Duhet të zhvillohet një plan për parandalimin e rënies. Ky plan përbëhet nga komponentët e mëposhtëm:**

Komponentët e planit të parandalimit të rënies:	
Nr:	Komponentët e Planit:
1	Politikat për parandalimin e rënies nga vendpunimi
2	Përgjegjësitë për zhvillimin e një sistemi të sigurt të punës
3	Vlerësimi i riskut për të punuar në lartësi
4	Procedurat që do të përdoren kur punohet në lartësi përfshirë lejet e punës
5	Përdorimi i pajisjeve mbrojtëse
6	Përdorimi i pajisjeve mbrojtëse dhe të qasjes
7	Marrëveshjet e inspektimit
8	Marrëveshjet e mirëmbajtjes
9	Udhëzimet dhe trajnimi
10	Reagimet emergjente

## Kur zhvilloni një vlerësim të rrezikut për punë në lartësi duhet të keni parasysh:

Respektimin e hierarkisë së kontrolleve të rrezikut në mënyrë sistematike dhe vetëm kur një nivel nuk është arsyeshëm praktik, duhet të konsideroni nivelin tjetër.

Në praktikë, sistemi i sigurt i punës mund të përfshijë kombinim të niveleve.

Pasi të keni radhitur rreziqet tuaja dhe të keni identifikuar se kush dhe si mund të lëndohet, mund të filloni procesin e vlerësimit të rreziqeve duke përdorur hapat e paraqitura më poshtë:

1. Identifikoni rreziqet e punës në lartësi

2. Vlerësoni rreziqet e punës në lartësi

3. Regjistroni gjetje

4. Zbatoni dhe monitoroni kontrollet


5. Inspektoni punimet dhe mbani kontrollet

**Puna në kulme është me rrezik të lartë, ndërsa rënia nga kulmet e ndjeshme dhe me ndriçim të dobët janë një ndër shkaqet më të zakonshme të vdekjes dhe lëndimit serioz në vendin e punës.**

Sikur në ndërtim, këto aksidente mund të ndodhin edhe kryhen punimet e riparimit ose pastrimit në kulmet e fabrikave, depove dhe ndërtesave të fermave.

Situatat dhe vendet në vijim paraqesin ndjeshmëri të theksuar:

- Ndriçimi i kulmit
- Panelet ndarëse në kulmet me panel
- Bllloqet e pa-armuara të çimentos.
- Panelet e ndryshkura metalike.
- Xhamat (përfshirë xhamat me tela).
- Dërrasat e kalbura.
- Pllakat e ndryshme.



# TRAJNIMI DHE NDËRGJEGJËSIMI

Personat që punojnë në lartësi të cilët janë të ekspozuar ndaj rrezikut të rënies duhet të pajisen me informacione, udhëzime dhe trajnime të mjaftueshme dhe të duhura në mënyrë që të kenë aftësi dhe njohuri për të kryer punën në mënyrë të sigurt.

Një pajisje e tillë duhet t'i ndihmojë ata të kuptojnë:

- Natyrën e rreziqeve nga rënia ndaj të cilave ata janë të ekspozuar.
- Rrezikun e lëndimit që ndërlidhet me detyrën.
- Masat e kontrollit që janë të nevojshme, përfshirë pajisjet, procedurat dhe përdorimin e PMP-ve.
- Përdorimin dhe mirëmbajtjen e duhur të pajisjeve, përfshirë inspektimin e tyre.
- Procedurat që duhen ndjekur në rast të një emergjence të tillë si shpëtimi, aksidenti ose lëndimi.

## Si vendosni nëse dikush është “i aftë” të punojë në lartësi?

Duhet të siguroheni që janë të punësuarnerëz me aftësi, njohuri dhe përvojë të mjaftueshme për të kryer një detyrë të tillë, ose, nëse punëtorët e tillë janë duke u trajnuar, duhet të siguroheni që punën e tyre të jenë duke e kryer nën mbikëqyrjen e një personi kompetent.

Në rastin e detyrave me rrezik të ulët, me kohëzgjatje të shkurtër (kohëzgjatja e shkurtër do të thotë detyra që zgjasin më pak se 30 minuta) që përfshijnë shkallët, aftësia e kërkuar është të sigurohet që punëtorët të jenë udhëzuar siç duhet në përdorimin e pajisjeve në mënyrë të sigurt (p.sh. si të lidhin një shkallë si duhet) si dhe të jenë trajnuar siç duhet. Trajnimi shpesh zhvillohet në punë, jo gjithmonë në klasë.

Kur kërkohet një nivel më teknik i aftësive, për shembull hartimi i një plani për montimin e një skele komplekse, skemat ekzistuese të trajnimit dhe çertifikimit të hartuara nga shoqatat ekonomike dhe industrisë, janë një mënyrë për të ndihmuar në demonstrimin e aftësive.



# LEJA PËR TË PUNUAR NË LARTËSI

Ekzistojnë situata për punë që kryhen në lartësi ku kërkohen kontrole më rigoroze . Në këto situata, mund të kërkohet një "leje pune" - e cila siguron që qasja për të punuar në lartësi i nënshtrohet kontrollit.

Sistemi i lejes për punë është një proces zyrtar i dokumentuar që përdoret për të menaxhuar punën e identifikuar si punë potencialisht e rrezikshme. Sistemi i lejes për punë synon:

Figura 2 - Leje Pune

- Të sigurojë një autorizim sistematik dhe të nivelizuar për punë të rrezikshme.
- T'u mundësojë personave përgjegjës të jenë të vetëdijshëm për të gjitha punët e rrezikshme, vendndodhjet e tyre dhe kur puna përfundon.
- Të vendos një qasje e standardizuar me përgjegjësi të qarta individuale për të marrë të gjitha masat e praktikueshme në masë të arsyeshme me qëllim që të sigurohet që puna të kryhet në mënyrë të sigurt.
- Të sigurojë mbikëqyrje shtesë për punën e rrezikshme, duke e monitoruar punën dhe paraqitjen vizuale.
- Të sigurojë një pamje vizuale (të lejes së punës) për të identifikuar qartë vendet ku do të kryhen detyrat e miratuara dhe kohëzgjatjen e tyre.

Projekti:				
Mbikëqyrësi(it) përgjegjës				
Punëtor(ët) e angazhuar:				
Përshkrimi i detyrave:				
Mjetet dhe pajisjet	Radhisi të gjitha pajisjet që do të përdorni për vlerësimin e zonës së punës dhe kryerjen e punës si dhe masat e ndërmarra paraprake që lidhen me to			
Trajnimi dhe Aftësimi	Radhisi të gjitha trajnimet dhe certifikimet e verifikuara kundrejt matricës së trajnimeve			
Vlerësimi i riskut	Janë kryer vlerësimet e mjaftueshme dhe të përshtatshme rrezikut dhe rreziqet në vijim janë identifikuar:			
Qasja/Dalja	Qasje e sigurt në zonën e punës për të gjitha operativat	Po	Jo	Asnjëra
	Qasje e sigurt në zonën e punës për të gjithë punëtorët			
	Terreni i fortë për qasje mobile/skele të shkallëve, etj.			
	Janë identifikuar shërbimet/pengesat e larta dhe janë komunikuar/izoluar			
	Kulmet, shkallët dhe mjetet e tjera të qasjes janë në gjendje të mirë			
	Sistemet për heqje të sigurt të mbeturinave janë të caktuara			
	Zonat e ndjeshme të kulmeve/sigurisë janë identifikuar dhe shënuar			
Mbrojtja nga rënia	<i>Mbrojtje adekuatë nga rënia (shëno të gjitha nëse janë të aplikueshme)</i>	Po	Jo	Asnjëra
	Aty ku është e nevojshme janë vendosur pengesat mbrojtëse			
	Një pengesë e duhur kundër rënies është vendosur			
	Një pengesë e duhur kundër rënies është zgjedhur dhe inspektuar për punën			
	Një spirancë e duhur është përzgjedhur nga një person kompetent			
	Rrjeta e sigurisë është instaluar nga një person i kualifikuar			
	Janë siguruar mjetet dhe materialet kundër rënies			
Siguria e përgjithshme	Tregoni se si janë duke u mbrojtur pjesa tjetër e personelit dhe publiku (p.sh. me anë të përdorimit të pengesave apo shenjave)			
Autorizuar nga:	Nënshkrimi	Data e lëshimit dhe koha	Data e skadimit:	
Pranuar nga	Nënshkrimi	Data e Kthimit dhe koha		



### **Leja e punës nuk është thjesht leje për të kryer një detyrë të rrezikshme.**

Leja, në vetvete, nuk e bën një detyrë të sigurt. Përmirësimet e sigurisë mund të arrihen vetëm përmes personave që përgatiten për punë (p.sh. masat e zbatuara të kontrollit), personave që mbikëqyrin punën (p.sh. duke përgatitur VSP-të) dhe personave që kryejnë punën (p.sh. duke përdorur PMP-të sipas planit).

Sigurimi i trajnimit adekuat i personave në të gjitha nivelet, që përfshihen në sistemin e lejes së punës është thelbësore për të arritur një zbatim të qëndrueshëm dhe efektiv. Nivelet e ndryshme të vlerësimit dhe miratimit sigurojnë që personat e autorizuar dhe kompetentë kanë menduar për rreziqet e parashikueshme dhe që rreziqet e tilla të zbuten në mënyrë efektive.

Është e rëndësishme të sigurohet që leja, e cila është marrë, t'u komunikohet në mënyrë efektive të gjithë personave të përfshirë në detyrë, me qëllim që ata të kuptojnë rreziqet dhe masat e kontrollit të rreziqeve dhe si ata ta kryejnë punën në mënyrë të sigurt.

## **PLANI I EMERGJENCËS**

Është praktikë e mirë të zhvilloni një plan të shkruar për reagim ndaj emergjencave për punë më komplekse për punët të cilat kryhen në lartësi. Operacionet e shpëtimit shpesh kryhen nën stres shumë të lartë dhe duhet të merren parasysh të gjitha aspektet e procesit të shpëtimit.

### **Elementet që duhet të merren parasysh duhet të përfshijnë:**

- Metodatat ose pajisjet e duhura të shpëtimit.
- Procedurat për qasje në zona më pak të arritshme.
- Trajnimin e nevojshëm për shpëtuesit dhe ofruesit e ndihmës së parë.
- Detaje të shërbimeve të emergjencës, ambulancës dhe spitaleve.
- Një mjet komunikimi efektiv, i cili është gjithmonë në dispozicion.



### Pajisjet e shpëtimit

Varësisht nga lloji i punës që kryhet, si dhe lartësisë së ndërtesës ose rrethanave specifike të vendit, mund t'ju duhet të përdorni pajisje shpëtimi aq të thjeshta siç janë shkallët, ose aq të komplikuar siç është vinçi.

Në disa situata, mund t'ju duhet të merrni në konsideratë PNMP-të (platforma ngritëse mobile të punës), shporta për njerëz, vinça ose sisteme të shpëtimit në dispozicion.

## PLATFORMA DHE PAJISJET PËR QASJE

Kur punohet në lartësi, ekzistojnë një larmi opsionesh të cilat ndihmojnë në sigurimin e qasjes dhe mbrojtjes nga rënia, përfshirë këtu:

### Platforma Ngritëse Mobile të Punës (PNMP)

Nëse po mendoni të përdorni një PNMP-të, merrni parasysh pyetjet e mëposhtme:

- **Lartësia** – Sa është lartësia nga toka tek vendi ku do të kryhet puna?
- **Përdorimi** – A keni PNMP-të e duhura për punën? (Nëse nuk jeni i sigurt, kontrolloni me pronarin ose prodhuesin)
- **Kushtet** – Si janë kushtet tokësore? A ka rrezik që PNMP-ja të bëhen të paqëndrueshme ose të përmbysen?
- **Operatorët** – A janë personat që përdorin PNMP-në të trajnuar, kompetent dhe të aftë për ta vepruar?
- **Pengesat** – A mund të pengohet PNMP-ja nga pengesa të jashtme ose të epërme, p.sh. konstruksionet e çelikut, degët e pemëve ose linjat e energjisë?
- **Trafiku** – A ka trafik afër dhe, nëse po, çfarë duhet të bëni për të parandaluar përplasjet?

- **Pengimi** – A keni nevojë të përdorni kufizime të punës (për të parandaluar largimin e njerëzve nga PNMP) ose për të parandaluar rënien (i cili do të ndalojë personin të godasë tokën nëse bie)? Lejimi i njerëzve që të dalin nga shporta nuk rekomandohet - a keni nevojë ta bëni këtë si pjesë integrale të punës?
- **Kontrollet** – A është ekzaminuar, inspektuar dhe mirëmbajtur PNMP-ja siç kërkohet nga udhëzimet e prodhuesit dhe a janë kryer kontrolle ditore?



### Shkallët dhe shkallët mobile

Para se të filloni një detyrë me shkallë, gjithmonë duhet të kryeni një kontroll “para përdorimit” për të dalluar ndonjë defekt të dukshëm për të siguruar që shkalla është e sigurt që të përdoret.

#### Duhet të kryhet një kontroll para përdorimit:

- Nga përdoruesi;
- Në fillim të ditës së punës;
- Pasi diçka të ketë ndryshuar, p.sh. një shkallë është hedhur ose lëvizur nga një zonë e ndotur në një zonë të pastër (kontrolloni gjendjen e tyre).



#### Kur kryeni një kontroll para përdorimit:

- **Kontrolloni shkallët** – sigurohuni që ato të mos jenë të shtrembëruara ose të dëmtuara, pasi shkalla mund të thyhet ose të shembet.
- **Kontrolloni këmbët**– nëse mungojnë pjesë, nëse janë vjetruar ose dëmtuar, shkalla mund të rrëshqasë. Kontrolloni gjithashtu këmbët e shkallëve kur lëvizni nga toka e butë/e ndyrë (p.sh. tokë e gërmuar, rërë/zhavor, një punishte e papastër) në një sipërfaqe të lëmuar dhe të fortë (p.sh. pllaka), për të siguruar që këmbët e jo papastërtitë (p.sh. dheu, copëza ose gurë të ngulitur) janë në kontakt me tokën.
- **Kontrolloni këmbëzat** – nëse ato janë të shtrembëruara, të vjetruara, që mungojnë ose të lira, shkalla mund të dështojë.
- **Kontrolloni çdo mekanizëm shtrëngimi** – nëse ato janë të përkulura ose shtrëngimet janë vjetruar ose dëmtuar, shkalla mund të shembet. Sigurohuni që të jenë lidhur të gjitha shufrat e shtrëngimit.

- **Kontrolloni platformën e shkallëve mobile** – nëse është ethyer ose shtrënguar, shkalla mund të bëhet e paqëndrueshme ose të shembet.
- **Kontrolloni këmbëzat në shkallët mobile** – nëse janë të ndotura, ato mund të jenë të rrëshqitshme; nëse fiksime janë të lira në shkallë, ato mund të shemben.

**Nëse dalloni ndonjë nga defektet e mësipërme, mos i përdorni shkallët dhe njoftojeni punëdhënësin tuaj.**

**Kur përdorni një shkallë mobile për të kryer një detyrë:**

- Kontrolloni që të katër këmbët e shkallës janë në kontakt me tokën dhe këmbëzat janë në nivel.
- Mbani vetëm materiale dhe mjete të lehta.
- Mos e teproni në zgjatje.
- Mos qëndroni dhe punoni në tri këmbëzat e epërme (përfshirë këmbëzën që formon pjesën e epërme të shkallës) nëse nuk ka një mbajtëse të përshtatshme dore.
- Sigurohuni që çdo pjesë shtrënguese është në gjendje të mirë.
- Mundohuni të poziciononi shkallën përballë me aktivitetin e punës dhe të mos qëndrojë anash. Sidoqoftë, ka raste kur një vlerësim i rrezikut mund të tregojë se është më e sigurt të punohet anash, p.sh. në një dyqan i shitjes me pakicë ku nuk mund të përdorni shtrëngueset e shkallëve për të punuar përball për shkak të kufizimeve të hapësirës në korridoret e ngushta, por mund ta mbyllni plotësisht për të punuar anash.
- Mundohuni të shmangni punën që imponon ngarkesë anësore, siç është shpimi anësor përmes materialeve të ngurta (p.sh. tulla ose beton).
- Kur ngarkesat anësore nuk mund të shmangen, duhet të parandaloni që shkallët të mos përmbysen (p.sh. duke lidhur shkallët). Përndryshe, përdorni një lloj më të përshtatshëm të pajisjeve për atë punë.
- Mbani tre pika kontakti në pozicionin e punës. Kjo do të thotë dy këmbë dhe një dorë duhet të jenë në shkallë, ose kur të dy duart duhet të jenë të zëna me punë për një periudhë të shkurtër kohore, atëherë dy këmbët dhe trupi duhet të jenë të mbështetura në shkallë.

### Konstruksioni i Skelave Lëvizëse

Shumë njerëz lëndohen çdo vit kur bien nga skelet ose kur skeleja përmbysen. Skelet duhet të ngrihen nga njerëz të trajnuar dhe kompetentë. Incidentet që përfshijnë Konstruksionet e skeleve shkaktohen kryesisht nga:

- **Metodat e rrezikshme të montimit ose çmontimit** – ku nuk ndiqet një sistem i sigurt.
- **Defektet në skelen e montuar** – aty ku struktura e konstruksionit është lidhur gabimisht ose aty ku mungon një mbrojtëse e platformës.
- **Keqpërdorimi i skeles** – ku shkalla përdoret në një skele duke shkaktuar përmbysjen e saj ose kur një person bie ndërsa skeleja lëviz.



### **Montimit dhe çmontimi:**

Prodhuksi, furnizuesi ose qiramarrësi ka për detyrë të sigurojë një manual udhëzimi që shpjegon rrjedhën e montimit, duke përfshirë çdo kërkesë të lidhjes së tyre. Shtyllat duhet të ngrihen duke ndjekur një metodë të sigurt pune, qoftë duke përdorur:

- **Sistem mbrojtës me parrak** – ku parrakët e përkohshëm mbrojtës shtrëngohen nga një nivel më poshtë dhe lëvizin deri në nivel të platformës. Ato vendosen para se operatori të t'i qaset platformës për t'u përshtatur me parrakët e përhershëm mbrojtës.
- **Metoda "përmes kurthit"** – përfshinë operatorin që zë një pozicion pune në derën e kurthit të platformës, nga ku ata mund të shtojnë ose heqin përbërësit të cilët veprojnë si parrak mbrojtës në nivelin mbi platformë. Është krijuar për të siguruar që operatori të mos qëndrojë në platformë i pambrojtur.

### **Stabiliteti:**

Për të ruajtur stabilitetin e konstruksionit, duhet të siguroheni që:

- Skelet janë të mbështetura në tokë të fortë, të njëtrajtshme me pllaka bazë të mbështetura siç duhet
- Asnjëherë të mos përdorni tulla ose blloqe ndërtimi për të bartur peshën e ndonjë pjese të skeles
- Stabilizuesit ose rregullatorët të instalohen nëse manuali i udhëzimeve parasheh një kërkesë të tillë
- Që një skele të mos ngrihet kurrë në një lartësi mbi nivelin që rekomandohet nga prodhuksi.

### **Masat paraprake dhe inspektimi:**

Skelet duhet të jenë në përputhje me standardin e kërkuar për të gjitha llojet e skeleve, p.sh. parrakë të dyfishtë, dërrasa për ecje, mbështetës dhe shkallë për qasje.

Kur skelet blihen ose merren me qira, ato duhet të mbërrijnë me të gjitha pjesët e nevojshme për të parandaluar rëniet dhe për të siguruar qëndrueshmëri.

Skelet duhet të kenë të gjitha pjesët në vendet e duhura për të siguruar forcën e duhur. Ato mund të shemben nëse ndonjë pjesë lihet jashtë.

Të gjitha skelet duhet të inspektohen menjëherë pas montimit dhe pastaj në intervale të përshtatshme dhe të rregullta (çdo 7 ditë) nga një person kompetent. Ndaloni punën nëse inspektimi tregon se skelet nuk janë të sigurt dhe përmirësoni gabimet. Rezultati i një inspektimi duhet të regjistrohet dhe ruhet derisa në regjistrimin e inspektimit të radhës.

## AUDITIMET

Punëdhënësi duhet të ketë auditime të brendshme/vetë-inspektime sipas listës së sugjeruar në Shtojcë. Një gjë e tillë do t'u mundësojë atyre që të menaxhojnë në mënyrë efektive shëndetin dhe sigurinë dhe gjithashtu t'i përgatisë ata për çdo auditim të jashtëm siç janë Rregullatori (Inspektorati i Punës etj.) dhe Certifikimi, nëse ka të tilla.

## VËREJTJET PËRFUNDIMTARE

**Mbani mend:** Puna në lartësi bartë rrezik dhe punëdhënësit, për aq sa është mundur, duhet të ndërmarrin masat për të kontrolluar ato rreziqe. Ky Udhëzues duhet të përdoret për të ndihmuar zhvillimin e sistemeve të sigurta të punës, kurdo kryhet ndonjë punë në lartësi.

**Për më shumë informata, kontaktoni Inspektoratin e Punës.**

# SHTOJCA

Pyetjet e Auditimit të Punëdhënësit për “Punën në Lartësi” (Dokumenti Udhëzues), siç janë marrë nga dokumenti i listës së kontrollit të konsoliduar të Auditimit të SSHP-së të BE-së, i zhvilluar në mars të vitit 2021, janë paraqitur si më poshtë:

## Seksionet referuese:

### 2.6.4 Puna në lartësi

1. A është kryer vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut për punën në lartësi?
2. A është siguruar që puna në lartësi të jetë e sigurt në çdo vend pune?
3. A është siguruar informacion dhe trajnim i mjaftueshëm për punonjësit në lidhje me rreziqet e punës në lartësi dhe masat e mundshme parandaluese?
4. A ka pasur konsulta me punonjësit (dhe përfaqësuesit e tyre) në lidhje me punën në lartësi?
5. A përcaktohen dhe sigurohen oraret e rregullta të mirëmbajtjes për pajisjet (p.sh. platformat, shkallët, skelat etj.) dhe pajisjet e sigurisë (p.sh. spirancat, pajimet etj.)?
6. A është siguruar që çdo vend pune nën zonën ku kryhet puna në lartësi të jetë i sigurt, përfshirë edhe nga objektet që bien?
7. A është siguruar që rënia e materialeve nga vendet e punës në lartësi të jetë e sigurt?
8. A është siguruar që deponimi i materialeve dhe pajisjeve në zonat e punës në lartësi të jetë e sigurt?
9. A ka ndriçim të mjaftueshëm në zonat e punës në vendet e punës në lartësi?
10. A është siguruar që puna në muret brojtëse të kulmeve dhe hapjet e ndryshme të dyshemesë të jenë e sigurta për punëtorët?
11. A është siguruar që puna në kulm mund të kryhet në mënyrë të sigurt?
12. A është siguruar që puna në platforma të mund të kryhet në mënyrë të sigurt?
13. A është siguruar që puna në shkallët lëvizëse mund të kryhet në mënyrë të sigurt?
14. A është siguruar që puna në skela mund të kryhet në mënyrë të sigurt?
15. A është siguruar që puna në skelat e varura mund të kryhet në mënyrë të sigurt?
16. A është siguruar që puna në skelat lëvizëse mund të kryhet në mënyrë të sigurt?